

PROCESVERBAL
nga seanca e nëntëmbëdhjetë e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 19.11.2025

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, me. Zirjeta Jajaga, mr. Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski, Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, mr. Emilija Janevska, Cvetanka Mitrevska, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska-Jotevska, dr. Ivana Stojanovska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e nëntëmbëdhjetë të Këshillit. Seanca filloi në ora 18:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 18-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 17.11.2025.
2. Raport mbi prezantimin mediatik zgjedhor për rrethin e dytë të Zgjedhjeve lokale 2025
3. Raport mbi transmetimin e reklamave politike me pagesë gjatë kohës së rrethit të dytë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet lokale, në periudhën nga data 20 deri më 31 tetor 2025
4. Propozim-vendim për pagesën e kompensimit për vdekjen e anëtari të ngushtë të familjes të punësuar në Agjencion.
5. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi procesverbalin e propozuar nga seanca e 18-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 17.11.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Drejtori dr. Zoran Trajčevski shpjegoi Raportin e propozuar të prezantimit mediatik zgjedhor për rrethin e dytë të Zgjedhjeve lokale 2025. Ai shpjegoi se monitorimi i kryer nga Agjencia i referohet periudhës nga data 20 deri më 31 tetor 2025. Mostra e monitorimit edhe këtë herë përfshinte tre shërbime programore të ShPR Radio-televizioni i Maqedonisë: RTM1, RTM2 dhe Kanali i Kuvendit, si dhe 8 shërbime programore të televizioneve kombëtare komerciale: TV Sitel, TV Alfa, TV Kanal 5, TV Telma, TV Alsat-M, TV 21-M, TV Shenja dhe TV 24 Vesti. Për shërbimet e tjera programore u veprua në bazë të ankesave. Objekt i mbikëqyrjes ishte programi 24 - orësh për periudhën e fushatës zgjedhore dymbëdhjetëditore për rrethin e dytë të Zgjedhjeve lokale (nga data 20 deri më 31 tetor), gjatë së cilës u analizuan të gjitha format e prezantimit mediatik zgjedhor. Theksi u vu në edicionin qendror informativ ditor (lajme ose ditor) për secilin prej transmetuesve të listuar, dhe nga intervistat dhe debatet e transmetuara gjatë kësaj periudhe, u veçuan ata që preokupim tematik kishin zgjedhjet lokale. Monitorimi përfshiu edhe heshtjen zgjedhore – më 1 nëntor (gjithë ditën) dhe më 2 nëntor deri në ora 19:00. Në rrethin e dytë të zgjedhjeve u zbatua parimi i barazisë për kandidatët për kryetarë bashkie, përcaktuar në nenin 75-a të Kodit Zgjedhor, si bazë për arritjen e ekuilibrit në raportimin e zgjedhjeve. Nga ana sasiore, parimi nënkupton kohë afërsisht të barabartë midis kandidatëve për kryetarë bashkie, natyrisht në varësi të intensitetit të fushatave. Nga ana cilësore, ekuilibri arrihet me një qasje identike ndaj të gjithë kandidatëve, pra toni i raportimit dhe kornizave. Prezantimi mediatik zgjedhor përmes shërbimeve programore nga radio televizioni i Maqedonisë rregullohet me kërkesa të veçanta të përcaktuara në nenin 76-a të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit lajmet duhet të ndahen në përqindje si më poshtë: 30% e kohës për ngjarjet ditore nga vendi dhe bota, 30% për aktivitete të partive politike në pushtet, 30% për aktivitete të partive politike në opozitë dhe 10% për aktivitete të partive politike jashtëparlamentare dhe për kandidatët e pavarur. Gjithashtu, raportim mbi procesin zgjedhor u mundësua dhe për personat me aftësi të kufizuara shqisore, në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor. Shërbimet programore të RTM-së dhe tetë televizione komerciale që u përfshinë nga monitorimi i Agjencisë bënë përpjekje për t'u ofruar informacion të detajuar shikuesve si votues potencialë në fushatën zgjedhore të kandidatëve për kryetarë bashkie për rrethin e dytë të Zgjedhjeve lokale 2025. U publikuan një numër i madh raportesh mbi rrethin e parë të Zgjedhjeve lokale, u bënë analiza të emisioneve që u transmetuan dhe u komentuan rezultatet e rrethit të parë të zgjedhjeve. U sigurua prezantim i gjerë i ngjarjeve të tjera aktuale gjatë kohës së rrethit të dytë të fushatës zgjedhore. Mund të thuhet se, gjatë mbulimit mediatik të fushatës zgjedhore në rrethin e dytë të zgjedhjeve, mediat në përgjithësi, disa më shumë, disa më pak, iu përmbajtën rregullave profesionale për drejtësi, ekuilibër dhe paanshmëri, duke respektuar parimin e barazisë ndaj kandidatëve të mbetur për kryetarë bashkie. Gjatë raportimit për pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore për rrethin e dytë, mediat treguan qasje të ndryshme editoriale. Disa u përpoqën të paraqisnin sa më shumë kandidatë, disa u përqendruan kryesisht te kandidatët nga katër koalicionet kryesore, dhe disa kryesisht te kandidatët për kryetarë bashkie në komunat e Shkupit dhe rivalët për kryetar bashkie të Shkupit. Shërbimi publik në rrethin e dytë të procesit zgjedhor, përkatësisht Zgjedhjet lokale 2025, RTM1, përkatësisht RTM2, përmbushën detyrimet e veçanta ligjore. Për temën e zgjedhjeve, përveç dy shërbimeve programore të shërbimit publik, më shumë kohë në lajme i kushtuan TV Sitel dhe TV Alfa. Me lajmet e orës 16:00 dhe intervistat e transmetuara në orën 19:00, dhe TV Alsat M i kushtoi kohë të konsiderueshme rrethit të dytë të zgjedhjeve lokale. Më pak informacion rreth zgjedhjeve kishte në lajmet e TV Telma dhe

TV Shenja, ku të dy mediat i kushtuan më pak se 1 orë e gjysmë në gjithsej 12 edicione lajmesh nga rrethi i dytë zgjedhor. Mbulimin më të madh të pjesëmarrësve në zgjedhje ofruan TV Alfa (me informacion rreth kandidatëve nga të gjithë paraqitësit e listave nga koalicionet dhe partitë politike dhe rreth pesë kandidatë të pavarur), i ndjekur nga RTM1 (me informacione për kandidatët e të gjithë bartësve të listave të koalicioneve dhe partive politike dhe katër kandidatë të pavarur) dhe RTM2 (me informacione për pesë kandidatë të pavarur, por pa informacion për kandidatin nga e vetmja parti joparlamentare në rrethin e dytë). Të gjitha mediat e analizuara në përgjithësi raportuan në mënyrë neutrale për pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore për rrethin e dytë. TV Alfa në disa raportime paraqiti pozitivisht Koalicionin e udhëhequr nga VMRO-DPMNE, dhe negativisht koalicionet e udhëhequra nga LSDM dhe BDI. Në emisionet speciale të lajmeve, përkatësisht intervista dhe debate, më shumë intervista u transmetuan nga TV 24 Vesti (13), TV Alfa (13) dhe RTM1 (11). TV Alsat-M dhe TV Sitel intervistat i transmetuan në kuadër të emisioneve të lajmeve ditore, dhe TV Sitel transmetoi një intervistë në programin e rregullt të mëngjesit. Shumica e intervistave u realizuan me ekspertë dhe analistë. Më shumë intervista me pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në zgjedhje/kandidatë për kryetar bashkie kishte TV Sitel. Shërbimi publik radiodifuziv dhe televizionet kombëtare që transmetuan reklama politike me pagesë përmbushën detyrimin ligjor për periudhën gjatë rrethit të dytë të fushatës zgjedhore për të ofruar informacion në mënyrë të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara shqisore përmes - një edicioni të lajmeve çdo ditë dhe një edicioni të programi aktual informativ në javë. Në rrethin e dytë të Zgjedhjeve lokale, prezantim mediatik pa pagesë transmetoi vetëm shërbimi i Kuvendit, në total për rreth 43 minuta, për kandidatët nga dy koalicionet e udhëhequra nga VMRO-DPMNE dhe LSDM. RTM1 raportoi se asnjë kandidat nuk iu përgjigj thirrjes së tyre publike për prezantim mediatik pa pagesë, i cili nga data 22 deri më 30 tetor 2025 u transmetua disa herë, dhe u publikua në ueb-faqen e RTM-së. Këtë herë, për heshtjen zgjedhore, nga 1 nëntor gjatë gjithë ditës dhe 2 nëntor deri në orën 19:00, Agjencia nuk konstatoi asnjë shkelje të Kodit Zgjedhor.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, e falënderoi drejtorin për shpjegimin e hollësishëm dhe theksoi se raporti ishte përgatitur në mënyrë cilësore të lartë, dhe është në veçanti pozitive që nuk janë konstatuar shkelje të Ligjit nga asnjë transmetues.

Pika 3

Drejtori dr. Zoran Trajčevski shpjegoi Raportin e propozuar për transmetimin e reklamave politike me pagesë gjatë kohës së rrethit të dytë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet lokale, në periudhën nga 20 deri më 31 tetor 2025. Ai deklaroi se Raporti mbi reklamat politike me pagesë (RPP) në programet e transmetuesve, gjatë rrethit të dytë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet lokale 2025, në periudhën nga 20 deri më 31 tetor 2025, është përgatitur në bazë të detyrimit sipas nenit 76-d paragrafi (8) të Kodit Zgjedhor. Në rrethin e dytë të fushatës zgjedhore, duke pasur parasysh se në rrethin e parë në pjesë të madhe të komunave ishin zgjedhur kryetarët e komunave, përveç në komunën e Shuto Orizarës, në të gjitha komunat e tjera përfundoi procesi zgjedhor për zgjedhjen e Këshillit, përveç atyre katër komunave ku nuk kishte pjesëmarrje të mjaftueshme që procesi zgjedhor të përfundonte, koha për RPP e përdorur nga partitë politike dhe koalicionet, si dhe kandidatët e pavarur, ishte më e shkurtër krahasuar me rrethin e parë. Në të 22 televizionet së bashku, u transmetuan gjithsej 52 orë 56 minuta dhe 15 sekonda reklama politike me pagesë për Zgjedhjet lokale. Në të 19 radiot së bashku, u transmetuan gjithsej 47 orë 34 minuta dhe 31 sekonda reklama politike me pagesë. Në rrethin e dytë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet

lokale 2025, në televizione dhe radio u transmetuan gjithsej 100 orë 30 minuta dhe 46 sekonda reklama politike me pagesë. Nga 9 televizione kombëtare që nënshkruan kontrata për transmetim të RPP në rrethin e dytë të fushatës, vëllimi më të madh të kohës për reklama u transmetua nga TV Kanal 5, TV Alsat-M dhe TV Alfa. Nga 9 televizionet rajonale që nënshkruan kontrata për transmetim të RPP në rrethin e dytë të fushatës, vëllimi më të madh të kohës për reklama u transmetua nga TV Koha dhe TV EDO. Nga 4 televizionet lokale që nënshkruan kontrata për transmetim të RPP në rrethin e dytë të fushatës, vëllimin më të madh të kohës për reklama e transmetoi TV Uskana nga Kërçova, e ndjekur nga TV Kaltrina nga Struga, TV Protel Probishtip, ndërsa vëllimin më të vogël kishte TV Koçani. Nga gjithsej katër radio kombëtare, tre nënshkruan kontrata për transmetim të RPP, dhe kohën më të madhe të reklamave u transmetua nga RA Antena 5 dhe RA Kanal 77, e ndjekur nga RA Metropolis, ndërsa RA Jon nuk transmetoi RPP në rrethin e dytë. Nga 8 radiot rajonale që nënshkruan kontrata për transmetim të RPP në rrethin e dytë, kohën më të madhe të reklamave e transmetuan RA Siti dhe RA Klub FM. Nga 8 radiot lokale që nënshkruan kontrata për transmetim të RPP në rrethin e dytë të Zgjedhjeve Lokale, kohën më të madhe të reklamave e transmetuan RA Valandovo dhe RA Koçani. Spoti më i shkurtër reklamues i transmetuar në radio ishte në kohëzgjatje prej 10 sekonda, ndërsa spoti më i gjatë reklamues ishte 97 sekonda, i porositur nga Koalicioni "Maqedonia Juaj", udhëhequr nga VMRO-DPMNE. Në televizion më shumë kohë morrën dy koalicionet e udhëhequra nga partitë VMRO-DPMNE dhe BDI – Koalicioni Maqedonia Juaj. Nga pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore që u reklamuan në TV në rrethin e dytë, më pak kohë morri Koalicioni VLEN. Në radio më shumë kohë morrën dy koalicionet e udhëhequra nga partitë VMRO-DPMNE dhe LSDM – Koalicioni Maqedonia Juaj. Nga pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore që u reklamuan në radio, më pak kohë morri Koalicioni VLEN. Duhet theksuar se në rrethin e dytë zgjedhor, dy parti politike, Znam dhe Levica, nuk patën mundësi për reklamë për shkak të dispozitave të Kodit Zgjedhor, përkatësisht në rrethin e dytë zgjedhor, Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE nuk i dha kohë partisë politike Znam për reklamim politik me pagesë. Nga dy kandidatët e mbështetur nga grupe votuesish që u reklamuan në radio, më shumë kohë morri kandidati Goran Stojkovski Diro nga Kumanova dhe kandidati Mendi Qira, i cili ishte kandidat dhe tani është kryetar i komunës së Strugës. Në fund, ai shpjegoi se vazhdimi i raportit ofron tabela me të dhëna mbi reklamën politike me pagesë në 22 stacione televizive që transmetuan reklama politike me pagesë dhe 19 radio që gjithashtu transmetuan reklama politike me pagesë. Ky raport do t'i dorëzohet Komisionit Shtetëror Zgjedhor.

Kryetari Stefanovski deklaroi se raporti ishte përgatitur në mënyrë të plotë, ishte shqyrtuar tërësisht nga Këshilli dhe se ishte hartuar në mënyrë cilësore nga shërbimi.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Raportin për transmetimin e reklamave politike me pagesë gjatë kohës së rrethit të dytë të Zgjedhjeve lokale 2025, në periudhën nga data 20 deri më 31 tetor 2025, me tekstin e propozuar.

Në përputhje me Orarin e Komisionit Shtetëror Zgjedhor për zbatimin e aktiviteteve zgjedhore, Raporti për transmetimin e reklamave politike me pagesë gjatë kohës së rrethit të dytë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet lokale 2025 do t'i dorëzohet Komisionit Shtetëror Zgjedhor.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Raportin mbi transmetimin e reklamave politike me pagesë gjatë kohës së rrethit të dytë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet lokale 2025, në periudhën nga data 20 deri më 31 tetor 2025, ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 4

Drejtori dr. Zoran Trajčevski shpjegoi vendimin e propozuar për pagesën e kompensimit për shkak të vdekjes së anëtarit të familjes së ngushtë të punësuar në Agjencion. Ai theksoi se, në përputhje me Ligjin për marrëdhënie pune dhe Marrëveshjen kolektive të Agjencisë, propozohet që Këshilli të miratojë vendimin për pagesën e ndihmës financiare mbi këtë bazë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për pagesën e ndihmës financiare - kompensim për vdekjen e anëtarit të familjes së ngushtë - prindit (nënës), të punësuar në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në shumë prej dy pagave mesatare neto mujore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përkatësisht 90.704,00 (nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e katër) denarë.

Mjetet janë siguruar nga Planin Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025.

Pika 5

Të ndryshme

Nuk kishte diskutim për pikën "Të ndryshme".

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Mr. Sasho Stefanovski**